



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
FONDI I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM
TË KUJDESIT SHËNDETËSOR
Drejtoria e Shërbimeve dhe Menaxhimit të Aktiveve



Rr. "Sami Frashëri", nr. 8, Tiranë. Tel: +3554223815. E-mail: info@fsdksh.com.al. Web://www.fsdksh.com.al

Nr. ___ Prot.

Tiranë, më ___/___/ 2017

Shtojcë dokumenti për modifikim në DST:

P Ë R

Prokurimin me objekt

“Prodhim i formularëve dhe kartave të shëndetit“

Mbështetur në Ligjin nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit Publik”, Autoriteti Kontraktor(Fondi) vendosi të pasqyrojë ndryshimet e bëra në DST të prokurimit me objekt “Prodhim i formularëve dhe kartave të shëndetit“, publikuar njoftimi i kontratës në faqen e internetit të APP-së në datë 03.02.2017, botuar në Buletinin e Njoftimeve Publike në datë 06.02.2017 për tu hapur në datën 27.02.2017 ora 11⁰⁰

I- Ndryshimi i dokumentacionit të tenderit bëhet në shtojcën 8 të DST si më poshtë:

1.Kriteret e vecanta të kualifikimit, pika 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar, pika 4 Ishte

-Një vërtetim nga furnizuesi i energjisë elektrike, që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri, lëshuar jo më parë se 10 ditë nga data e hapjes së ofertave.

2.Kriteret e vecanta të kualifikimit, pika 2.3 kapaciteti teknik ,pika 1, gërma a) gërma b)

Ishte

- Furnizime të mëparshme të së njëjtës natyrë në një kontratë me vlerë jo më të ulët se 40% e fondit limit të kontratës, (në një vlerë jo më të ulët se 8,621,561.03 lekë), furnizimi të jetë i realizuar gjatë 3 viteve të fundit (2014, 2015, 2016) të aktivitetit të operatorit ekonomik.

Për të vërtetuar këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- a. Kur kontrata e së njëjtës natyrë është e realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar detyrimisht me vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e sukseshëm të kësaj kontrate .

OSE

- b. Kur kontrata e së njëjtës natyrë është realizuar me subjekte private Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë duke paraqitur faturën/at përkatëse tatimore të shitjes që mbulojnë vlerën e kontratës.

Bëhet

1.Kriteret e vecanta të kualifikimit, pika 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar, pika 4

Një vërtetim nga furnizuesi i energjisë elektrike, që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

2.Kriteret e vecanta të kualifikimit, pika 2.3 kapaciteti teknik pika 1, gërma a)gërma b)

Furnizime të mëparshme të ngjashme në një kontratë me vlerë jo më të ulët se 40% e fondit limit të kontratës, (në një vlerë jo më të ulët se 8,621,561.03 lekë), furnizimi të jetë i realizuar gjatë 3 viteve të fundit (2014, 2015, 2016) të aktivitetit të operatorit ekonomik.

Për të vërtetuar këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- a. Kur kontratat e ngjashme janë realizuar me institucionet shtetërore, operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë duke paraqitur vërtetimet e lëshuara nga institucionet shtetërore dhe faturat tatimore të shitjes ku shënohen datat ,shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- OSE**
- b. Kur kontratat e ngjashme janë realizuar me subjekte private operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë duke paraqitur faturën/at përkatëse tatimore të shitjes që mbulojnë vlerën e kontratës.

II-Ndryshimi i datës së hapjes të ofertave

Data e hapjes së ofertave ishte në datë 27.02.2017 ora 11⁰⁰

Data e hapjes së ofertave bëhet në datë 06.03.2017 ora 11⁰⁰

Modifikimet e dokumentave do të bëhen pjesë e dokumentave të tenderit dhe do të hidhen në websitin zyrtar të Agjensisë së Prokurimit Publik <http://www.app.gov.al/> .



Public Health Sector
